# DËSHMI ARKIVI

**A-451052**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Katër ndeshje në 10 ditë/ Kosova përballet me disa mungesa para grumbullimit |
| ADRESA | https://piranjat.al/sport/kater-ndeshje-ne-10-dite-kosova-perballet-me-disa-mungesa-para-grumbullimi-i104582 |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 06:43:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 06:30:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 102e9925354ce0eeee9fd3c515cc939e7509d18be7dbf6938e38fa6194903f76 |
| TEKSTI | 293984e6a27e0dd615c635fe00525b5c90adfcd04d72963c2dceff7f45daba4f |
| PAMJA | d60dd7c573ea46964ec09ea3d6150ddc5e224be12054db959384d9892d934a1f |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 71c1f1cf0f7be6ecf69635c7d5a03daeb635a0cc92c90330408372e68db79cab |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 7552192d4562aa207666eadcaed525346db194fc39c694c2be0ac3ebbafed5c8 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/71c1f1cf0f7be6ecf69635c7d5a03daeb635a0cc92c90330408372e68db79cab

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Katër ndeshje në 10 ditë/ Kosova përballet me disa mungesa para grumbullimit

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 08:30



Kosova do ta nisë ciklin e saj në Ligën B të Ligës së Kombeve më 24 shtator ndaj Irlandës në Prishtinë, ndërsa më pas e pret një kalendar i ngjeshur me katër ndeshje brenda dhjetë ditësh.

"Dardanët" do të udhëtojnë drejt Austrisë për duelin e 27 shtatorit, ndërsa më 1 tetor do të përballen me Izraelin në Hungari. Cikli do të mbyllet më 4 tetor në Prishtinë, sërish ndaj Austrisë.

Përzgjedhësi Franco Foda pritet të ketë disa probleme me formacionin, pasi disa lojtarë të rëndësishëm mund të mungojnë për shkak të dëmtimeve ose mungesës së minutave te klubet e tyre.

Amir Rrahmani nuk pritet të jetë pjesë e grumbullimit, pasi ka pezulluar angazhimin me përfaqësuesen pas mosmarrëveshjeve me Federatën e Futbollit të Kosovës.

Në mbrojtje mungesë e mundshme është edhe Kreshnik Hajrizi. Mbrojtësi, i cili u dëmtua në maj dhe iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale, ende nuk është rikuperuar plotësisht dhe pritet të mungojë në katër ndeshjet e radhës.

Probleme fizike ka edhe Elvis Rexhbeçaj. Mesfushori pësoi dëmtim gjatë një stërvitjeje me Wolfsburgun disa muaj më parë dhe ende nuk është rikthyer plotësisht në dispozicion.

Në dyshim mbetet Florent Muslija, i cili nuk ka luajtur që prej 24 prillit, kur pësoi dëmtim në gju. Mesfushori vijon procesin e rikuperimit dhe gjendja e tij do të përcaktojë nëse do të jetë në dispozicion të Fodës.

Edhe Fisnik Asllani mbetet një pikëpyetje. Sulmuesi është rikthyer së fundmi nga dëmtimi në gju dhe luajti disa minuta për Hoffenheimin ndaj Stuttgartit, por ende nuk dihet nëse është në gjendjen optimale për të përballuar ngarkesën e katër ndeshjeve.

Një situatë tjetër është ajo e Milot Rashicës, i cili ka pasur pak minuta këtë sezon te Besiktasi. Mungesa e hapësirës në klub mund të ndikojë edhe në përfshirjen e tij në listën e Kosovës.

Me katër ndeshje në vetëm dhjetë ditë, gjendja fizike e lojtarëve do të jetë një prej faktorëve kryesorë për përzgjedhjen e skuadrës. Lista e Franco Fodës pritet të publikohet të premten.

## Artikuj te sugjeruar

SPORT 17 Shtator08:12

### [Kane për Topin e Artë/ Hoeness kritikon Messin dhe Mbappen]

Uli Hoeness ka dalë hapur në mbështetje të Harry Kane për fitimin e Topit të Artë 2026. Presidenti nderi i Bayern Munichut ...

SPORT 16 Shtator23:09

**Milan zhgënjen në nisje të Europa League, Benfica fiton pastër! Tifozët e 'djallit' vërshëllejnë skuadrën**

Milan edhe pse me synimin për ti shkuar deri në fund kompeticionit nuk e ka nisur aspak mirë sezonin e ri në Europa League. 'Djalli&rs...

SPORT 16 Shtator22:30

**Nga makthi i tërheqjes nga futbolli te kthimi te goli, ish-mbrojtësi i Torinos sfidon Juventusin: Gati për derbin**

'Torino është shtëpia ime, në zemrën time. Jam shumë i kënaqur që jam këtu dhe jam gati për derbin. Kam ...

SPORT 16 Shtator18:17

**I shënoi gol Serbisë, Manaj pas vendimit të turpshëm të Hagës: UÇK nuk është vetëm një emër, por sakrificë**

Këtë të mërkurë u vendos dënimi i katër ish-krerëve të UÇK-së nga Trupi Gjykues i Dhomave të Speci...

SPORT 16 Shtator15:59

**Owen mbron Carrick: Shkarkimi i tij nga United do ishte vendim i nxituar**

Pas humbjes ndaj Cityt, të shumtë kanë qënë ata që kanë kërkuar largimin e trajnerit Carrick nga United. Ish-futb...

SPORT 16 Shtator15:49

**Haaland drejt Real Madridit? Gazetari spanjoll: Transferimi i norvegjezit është vetëm çështje kohe**

Thashethemet për një kalim të Erling Haaland te Real Madridi vazhdojnë të qarkullojnë, ndërsa gazetari Ruben Martin beson s...

SPORT 16 Shtator15:44

**Matthaus zbulon favoritin për Topin e Artë, nuk zgjedh as Mbappen dhe as Yamalin**

Lothar Matthaus, legjenda e futbollit gjerman dhe fituesi i Topit të Artë në vitin 1990, ka zbuluar favoritët e tij për çmimin...

SPORT 16 Shtator15:40

**Mundësi e artë për Mehmetin, titullar ndaj Arsenalit**

Anis Mehmeti do të debutojë për këtë sezon me Ipswich Town, teksa trajneri e ka përfshirë shqiptarin në formacionin ti...

SPORT 16 Shtator15:21

**Merr fund dilema/ Brajan Gruda zgjedh Gjermaninë dhe pritet të ftohet për Ligën e Kombeve**

Merr fund dilema për Brajan Grudën. Sulmuesi me prejardhje nga Shkodra pritet të zgjedhë Gjermaninë dhe të marrë ftesë...

SPORT 16 Shtator15:18

**"Kam humbur dy herë, dua ta provoj sërish finalen"/ Xhaka ëndërron suksesin me Sunderlandin**

Granit Xhaka ka një objektiv të qartë me Sunderlandin në Ligën e Evropës: të arrijë sërish në finale dhe k&e...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

**Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...**

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

KOSOVA 16 Shtator

**Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...**

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

LIFESTYLE 16 Shtator

**Prishtinë/ Shqiptarët protestojnë kundër vendim...**

Ndërkohë që në rrugët e Prishtinës po zhvillohen protesta e tubime lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



## E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.